

Aksion kundër kthimeve të premtën me 09. 09. 2005-08-22

Vizita e qendres së Partive me Autobusa
Takimi: 10 Ora, SPD-Zentrale
Willy-Brandt-Haus, Wilhelmstrasse 141
U-Bhf. Hallesches Tor

Tubimi, 17 Ora,
Pariser Platz,
S-Bhf.: Unter den Linden

Në Gjermani jetojnë zyrtarisht 7 Mio. Migrant dhe Refugjat. Dhe gjysmë Mio. prej tyre jetojnë pa dokumente dhe në kushte shumë të vështira. Edhe ata që e kanë Nënshetësin gjermane, nuk janë të sigurt, se edhe atyre mundet në çdo kohë të ju mirret Pasoshi gjerman, si momentalisht është rasti te 100.000 njerzë nga Turqia. Edhe pse po njihet në foljore realiteti i Migratimit, për shkak të konsumit të llojloshëm të Kulturave, megjithatë është jeta e Migrantve dhe Refugjatve në Gjermani prej racizimit, përjashtimeve dhe pandehjeve të përgjithshme e përcaktuar.

Një jetë njerzore për Migrantët dhe Refugjatët refuzohet sistematikisht, sepse „Civilizationit perëndimor“ ju nevojiten faktorët, që ata ti kenë si përgjegjës për Gjendjen e ligë sociale, deficitat Edukative, Kriminalitetin, Terrorizmin etj. Ata janë Objekte të përzgjedhur për Degradime sociale dhe për Forma të ndryshme të Represionit të kapitalizmit, ku ato së pari në ata zbatohen. Hartz IV bën pjesë në Form të madhe qe 12 vjet në jeten e përditshme të Refugjatve.

Qysh prej shumë viteve bëjnë pjesë:

- Ligje speciale (Zuwanderungsgesetz, Asylbewerberleistungsgesetz),
- Kufizime të Lëvizjes vetëm mbrenda një Komune (Rezidenzpflicht),
- Maltretim në Form të Bonave dhe 40 € në mujë,
- Burgosje në Kampe mbledhse dhe në Burgje të kthimeve,
- Frikë të përhershme për shkak të kthimeve (50.000 në vitë),
- Përjashtim nga partipacionet politike,
- Çnjohje e Procedurave të Asylytuesve,
- Pasiguri e përhershme për shkak të shtatusit të Duldungut (Kettenduldung),
- Ndarje e Migrantve dhe Refugjatve në ata të „dobishëm“ dhe „padobishëm“,
- Mbushja e mendjes se vetëm kjo kultura gjermane është si orientim për Integrim,
- Dhunime dhe vdekje për shkak të sulmimeve raciste nga Policia dhe Neonazistat,

ne jetën e përditshme të Migrantve dhe Refugjatve në Gjermani.

Ne jemi të gnopur, të ju tregojmë se në cilën gjendje të padurushme të përhershme kolonialiste ne po jetojmë. Ne nuk ko të apelojmë në ndërgjegjjen e „Demokracis qytetare“, sepse ata që nuk mundet ta përputhin këtë gjendje me ndërgjegjjen dhe pikëpamjen e tyre politike, ata do te veprojnë.

Ne dojmë ta bëjmë të qartë: Se edhe ne kemi të Drejt, të kemi një jetë njerzore, për të cilën ne gjithmonë dhe kudoqoftë do të luftojmë.

Shteteve Europiane dhe shoqatave të tyre duhet të jetë e qartë: Se ne nuk jemi „shfrytëzues“ të kësaj mirëqenie, si po pretendohet shpesh. Pasuria e këtij vendi është arritë nga plaçkitjet e vendeve tona. Ne jemi këtu se vendet tona janë shfrytëzuar dhe shkatërruar nga vendet perëndimore.

Ne apelojmë të Migrantët dhe Refugjatët: Ne nuk duhet të pranojmë më, që të trajtohem si njerzë të klasës së 2 apo 3. Askush për veqë ne nuk është Fuqia, që ta përfundon këtë gjendje. Ne nuk duhet të pranojmë, që të na ndajnë në Migrant dhe Refugjat të „mirë“ dhe të „keq“.

Vetëm me një Qëndrim dhe Solitaritet ndërkombëtar kemi shans, që ti bëjmë parallë këtyre sunduesve.

Ne nuk jemi të knaqukur kur i jipen vetëm një pakice drejta, por atëher kur të gjithë ti kanë te drejtat e barabarta.

Ne duhet të organizohem në çdo lami jetësore dhe duhet ti përbashkojmë iniciativat tona.

Ne duhet të luftojmë deri sa gjendja e tashme rrënjësisht është ndryshuar.

Edhe tashë janë në Berlin dhe Brandenburg qindra njerzë në rrezik kthimi. Kjo do të thotë: dorzim në shtetet ndjekse ku ata shpesh me tortura dhe vdekje përfundojnë. Kthimi i njerzve, të cilet një kohë të gjatë me Familjet e tyre kanë jetu këtu, sdo të thotë asgjë tjetër, përveqë se një pjesë e jetës së tyre po shkatërrohet. Kthimet të cilat mirren, ku ata do të jenë në rrezik jete, janë Akte alarmuese te praktikës raciste dhe ne i kundërshtojmë kësaj.

a.T

Mbarim me këtë gjendje të jetes në Gjermani, ligje speciale racise dhe kthime!

Drejt Qëndrimi për të gjithë-tashë dhe menjëherë!

Të luftojmë për të gjitha drejtat

Aleanca „Stopp Abschiebungen“